

## **SPECIFIKIME TEKNIKE**

OBJEKTI: Mirembajtje varreza publike dhe deshmoreve .

Per zerat e punes te parashikuara ne preventiv do te zbatohen punimet me kerkesat si poshte:

### **A-Specifikimet e proceseve te punes.**

#### **1. Mirëmbajtje dhe ruajtje parcelash.**

Në këtë preventiv janë përfshirë këto zëra punësh:

- Pastrimi I parcelave me sipërfaqe të gjelbër 24 herë në vit me fshesë dhe heqja e të gjitha mbeturinave
- Pastrimi I barit në rrugët e brendshme anash bordurave 5 herë në vit mbas kositjes së barit, kryesisht në periudhën Pranverë-Vjeshtë.
- Krasitje e drurëve, shkurreve dekorative si dhe punimi I tokes përreth tyre dy herë në vit (selvi dhe shkurre)
- Krasitja e bordurave të gjelbra (rozmarinë dhe levantinë) 4 herë në vit duke bërë dhe format e tyre
- Lyerja me gjeqere e të gjitha bordurave të rrugës dhe të varrezave provizore duhet të bëhet 3 herë në vit.
- Vaditja e drurëve dekorative dhe bordurave të gjelbërta .
- Ruajtja e varrezave publike dhe te deshmoreve. Ne total 10 roje, tre per varrezat e deshmoreve, gjashte per varrezat publike dhe nje roje eshte per te zevendesuar rojet e tjere ne dite festash, pushime , raporta etjer.

#### **2. Mbjellja e bordurave të gjelberta në parcelat e reja me levantinë dhe rozmarinë**

. Në çdo vit plotësohen parcela me varre provizorë . Në preventive është llogaritur që çdo vit këto parcela të plotësohen me 243 ml bordurë të gjelbër dhe deri sot ka vazhduar puna në mbjellje të reja të gardheve duke plotësuar parcelat me të gjithë elementët e saj.

#### **3. Mbjellje drurë dekorativ (selvi)**

Krahas mbjelljeve të gardheve të gjelbra në këto parcela, janë planifikuar të mbillen çdo vit edhe 75 copë drurë (selvi) të reja. Po ashtu të kryhet edhe ndonjë zëvendësim I ri në parcelat e vjetra nga tharjet apo dëmtimet.

#### **4. Mbjellje shkurre dekorative.**

Njekohesisht per te patur nje harmonizim te dekorit te larte dhe te ulet te gjelbert, pemeve dhe bordurave, realizojme nje kombinim dhe me mbjellje e 37 cope shkurre dekorative ( liguster).

## **5. Transporti I mbeturinave.**

Ne këtë process pune perfshihet grumbullimi I të gjitha mbetjeve që dalin nga pastrimi I varrezave , me pas transportimin e tyre në landfillin Bushat dhe pagesa e depozitimit nga vete sipërmarrësi. Parashikuar mesatarisht 13.1 ton mbetje te ndryshme ne muaj.

## **6. Energji elektrike per ndricim.**

Ne baze te VKM nr 712, dsate 29.10.2014 « Per miratimin e rregullores se funksionimit te varrezave » , nje nder kerkesat kryesore eshte dhe ndricimi i ambienteve naten. Meqenese firma ka bere instalimet e ndricuesve, lind nevoja e pageses se kkonsumit te energjise elektrike. Kemi te instaluar ne gjithe siperfaaqen e parcelave 20 prozhektore 100W.

## **7. Uje per vaditjen e pemeve dekorative dhe bordurave te gjelberta.**

Duke marre ne konsiderate investimin e pervitshem qe behet per mbjelljen e drureve dekorative (selvi) dhe bordura te gjelberta, lind e domosdoshme sherbimi i ndaj tyre, vaditja. Per kete kemi vendosur zerin , uje per vaditje .

## **8. Mirembajtja e varrezave te Deshmoreve.**

Sherbimi i mirembajtjes ne varrezat e Deshmoreve, konsiston ne mirembajtjen e tij, duke e pastruar, heqje barnash te keqia,sherbetisur,riparime suvatimi etjer.

## **C.Sherbimi I varrimit, ne varrezat publike.**

Sherbimi I Varrimit do të kryhet nga sipërmarrësi I mirëmbajtjes së varrezave sipas preventivave të hartuara nga Ndwrmarraja e Shwrbimeve dhe Punwve Publike.

### **Sherbimit te varrimit perfshin:**

- Hapje dhe mbyllje varri, pregatitje vendosje varri provizor,

Per mirembajtjen e varrezave dhe sherbimin publik te varrimit do te zbatohen edhe kushtet e percaktuara ne Ligjin nr. 9220 dt.15.4.2004, “Mbi sherbimin publik te varrimit, ne V.K.M. nr.711 dt. 29.10.2014 “Per miratimin e rregullores. Per administrimin dhe funksionimin e varrezave ne territorin e Republikes se Shqiperise,, dhe ne V.K.M. nr.712 dt. 29.10.2014 “Per miratimin e rregullores teknike, Per projektimin dhe ndertimin e varrezave ne territorin e Republikes se Shqiperise”.

-Dimensionet e pllakave b/a per varret hermetik dhe provizore, per te rritur dhe te vegjel, jane paraqitur ne skicat bashkelidhur.

Eshte parashikuar fondi limit qe duhet te paguaj qytetari per sherbimin e varrimit.

